



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 2411

Prishtinë, Dt. 15/07/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji- Biologji MSc
Projektpropozimi	Trajtimi me <i>Heridium erinaceus</i> i minjeve me sklerozë multiple të shkaktuar kimikisht me cuprizonë.
Kandidati	Laureta Hamza
Mentori	Prof.asst.dr. Ilir Mazreku
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: Vendimi nr.:
Vlerësimi i dorëshkrimit Në temën shkruar kandidatja përshkruan dizajnin eksperimental dhe në mënyrë korrekte formulon konceptin e shtuar për hulumtim. Tema e Masterit përmban: -Tetë (8) kapituj që janë të parashikuar edhe në modelin e temës së masterit në faqen e universitetit. -Në kapitullin Hyrje, kandidatja përshkruan në hollësi problematikën e hulumtuar dhe elementet që duhet analizohen në lidhje me sklerozën multiple, kafshën eksperimentale, anatominë si dhe materialet me të cilat paraprakisht është trajtuar kafsha. Në detaje dhe me referenca jepen informacione në lidhje me efektet e këtyre kemikateve, rrugëve të depërtimit dhe mekanizmin e veprimit të tyre. -Në kapitullin Qëllimi, kandidatja përshkruan në detaje dhe saktë qëllimin dhe objektivat e	

hulumtimit.

-Në kapitullin Materiali dhe metodat kandidatja përshkruan të gjitha materialet e përdorura në hulumtim, për shkaktimin dhe trajtimin e sklerozes multiple. Njëkohësisht ajo përshkruan metodologjinë e trajtimit të afshëve laboratorike, dhe matjeve të bëra të parametrave të rëndësishëm për sklerozën multiple.

Tek rezultatet kandidatja në (5 tabela) paraqet rezultatet e pëpunuara statistikisht dhe komentimin e tyre.

Në kapitullin e diskutimit kandidatja përshkruan dallimet dhe ngjajshmëritë e rezultateve të saj dhe të autorëve tjerë, për sklerozën multiple tek minjt laboratorik.

E gjithë tema përfundon me konkluzionet e nxjerruara:

- Përdorimi i cuprizonë shkakton dëmtim të mielinës në sistemin nervor qendror, duke shkaktuar sklerozën e shumëfishtë, siç janë humbja e mielinës dhe çrregullimet neurologjike.
- Trajtimi me *Heridium erinaceus* stimulon rigjenerimin e mielinës në minjtë e prekur nga skleroza e shumëfishtë të shkaktuar nga cuprizonë. Ekstraktet e *Heridium erinaceus* treguan përmirësime në simptomatologjinë neurologjike dhe strukturalen e trurit, duke ndihmuar në rikthimin e funksioneve të dëmtuara neurokognitive. Kjo mbështet potencialin e *Heridium erinaceus* si një agjent terapeutik të mundshëm në trajtimin e sëmundjeve neurodegeneruese si skleroza e shumëfishtë, duke ofruar mundësi për zhvillimin e terapive të reja për këtë sëmundje të vështirë.
- Megjithatë, kërkohet hulumtim shtesë për të kuptuar mekanizmat e veprimit dhe efektivitetin afatgjatë të tyre.

III. Përfundimi dhe propozimi

Bazuar në atë që u tha me lartë konkludoj se tema Master "*Trajtimi me Heridium erinaceus i minjve me sklerozë multiple të shkaktuar kimikisht me cuprizonë*" i kandidatës Laureta Hamza, është një punim i mirfilltë kërkimor-shkencor dhe pritet të jep një kontribut modest në fushën e shkencave mjedisore, me theks të veçantë në ekotoksikologjinë e ndotësve dhe

suplementeve ushqimore, andaj i propozojmë KMSH të Departamentit të Biologjisë dhe të FSHMN-së të:

- propozojmë që të lëshohet vendimi për mbrojtje të temës të kandidatës **Laureta Hamza**

Prishtinë, _15/07/2025_____

Komisioni:

1. _____

/ / Prof.dr.Kemajl Bislimi – anëtar/

2. _____

Prof. asst.dr.Ilir Mazreku – anëtar/mentor

3. _____

/Prof.dr.Avni Berisha – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.